



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1211 / prot.  
3

Tiranë më 13.10.2017

REKOMANDIM

Nr. 40, datë 13.10.2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.216, datë 11.09.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Firdeus Security" sh.p.k Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Firdeus Security" sh.p.k Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.216 datë 11.09.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "Firdeus Security shpk", është subjekt juridik me NIPT: K61628006R, me objekt: "Sigurimin e objekteve publike dhe private, sigurimin dhe mbrojtjen e jetës të personave fizikë, si dhe shoqërimin e vlerave monetare e materiale".

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit;
2. Kontrolluesi nuk disponon rregullorë për mbledhjen përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale;

4. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme nëpërmjet sistemit të video-surveimit. Koha e ruajtjes së të dhënave në sistem për godinën ku ushtron aktivitet, është 20 ditë. Konstatohet se nuk janë vendosur tabela informuese sipas modelit standard të miratuar nëpërmjet Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" në hyrje të ambienteve në të cilin ushtron aktivitetin;
5. Kontrolluesi nuk ka publikuar "Politikat e Privatësisë" në portalin zyrtar të <https://www.firdeussecurity.com>. Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë;
6. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave "punëmarrës" në lidhje me përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit gjeolokalizimit (GPS) të vendosur në mjetet motorrike të kompanisë dhe me të cilët lëvizin me qëllim përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

Zyra e Komisionerit konkludon se kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenet 18, 21-23, 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera"

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me qëllim ushtrimin e së drejtës për tu dëgjuar nga Zyra e Komisionerit përpara marrjes së vendimit përfundimtar, kontrolluesi është njoftuar zyrtarisht dhe ka marrë pjesë në seancën dëgjimore që u zhvillua më datë 09.10.2017.

Përfaqësuesi i kontrolluesit me autorizim u paraqit në seancë dëgjimore dhe deklaroi se më datë 29.09.2017 ka kryer "Njoffimin" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe ka depozituar gjithashtu prova dhe fakte që dokumentojnë rekuperimin e menjëhershëm të shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ si vijon:

1. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në subjektin "Firdeus Security shpk";
2. Deklaratë konfidencialiteti sipas modelit standard të miratuar nga Zyra e Komisionerit;
3. Dokument që informon subjektet e të dhënave "punëmarrës" në lidhje me përdorimin e sistemit të gjeolokalizimit GPS në mjetet motorrike të shoqërisë dhe me të cilët lëvizin me qëllim ushtrimin e detyrave të ngarkuara;
4. Tabelë informuese mbi prezencën e sistemit të video-surveimit CCTV.

Zyra e Komisionerit mbas verifikimit të dokumentacionit të grumbulluar gjatë procesit të hetimit dhe provave të paraqitura nga kontrolluesi më datë 21.09.2017 konkludon se:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" pranë Zyrës së Komisionerit por informacioni i deklaruar nuk është i plotë sa i përket kategorisë së subjekteve të të dhënave, kategoria e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin e përpunimit të tyre, përhapjen e të dhënave drejt palëve të treta etj.
2. Kontrolluesi nuk e ka plotësuar detyrimin për informimin e subjekteve të të dhënave, sipas pikës së pestë të procesverbalit të mbajtur. Publikimi i "Politikave të Privatësisë" në portalin e kontrolluesit <https://www.firdeussecurity.com>, ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
3. Tabela informuese e paraqitur në seancë dëgjimore nuk është sipas modelit standard të miratuar nëpërmjet Udhëzimit Nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

Gjatë seancës dëgjimore, kontrolluesi ka shprehur gadishmërinë për marrjen e masave për rikuperimin e shkeljeve në vazhdimësi.

Sa më sipër,

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Firdeus Security shpk". Tiranë, të realizojë në vazhdimësi përditësimin e Formularit të Njoftimit.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Firdeus Security shpk" Tiranë të hartojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij rubrikën "Politikat e Privatësisë".
3. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Firdeus Security shpk" Tiranë, të standartizojë tabelat informuese në përputhje me Udhëzimin Nr.3 datë 05.03.2010 "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".
4. Kontrolluesi "Firdeus Security shpk" Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të

ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.102017

**KOMISIONERI**  
  
**Besnik Dervishi**  
